



ÇFARË ËSHTË KONTROLLI?

Zhvillimi i kancerit të zorrës së trashë paraprihet thuajse gjithmonë nga shfaqja e **lezioneve beninje në zorrë** (polipe ose adenoma).

Kontrolli për parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të zorrës së trashë synon identifikimin e këtyre lezioneve parakanceroze, në mënyrë që të mund të jepet në kohë trajtimi **efektiv**.

Intervali i moshës për kontrollin është zgjatur **përtej moshës 69-vjeçare** për të mbuluar të gjithë personat e moshës **50 deri 74 vjeç**.

ALBANESE

Regione Emilia-Romagna

SERVIZIO SANITARIO REGIONALE
EMILIA-ROMAGNA

DO TË DOJE MË SHUMË INFORMACION?

Na vizito online

regioneer.it/colon



ose na telefono në numrin pa pagesë

800 033 033

çdo ditë nga ora 8:30 deri në 18:00 dhe të shtunën nga ora 8:30 deri në 13:00.



**ËSHTË I THJESHTË,
FALAS DHE MUND TË TË
SHPËTOJË JETËN.**

Regione Emilia-Romagna

SERVIZIO SANITARIO REGIONALE
EMILIA-ROMAGNA

KONTROLLI MUND TË TË SHPËTOJË JETËN!

Kontrolli është i thjeshtë, falas dhe efektiv, sepse nëse sëmundja kapet në fazë të hershme, rikuperimi i plotë ka më shumë gjasa. Kanceri i zorrës së trashë është:

I DYTI MË I DIAGNOSTIKUARI

I DYTI MË FATAL NË POPULLSINË ITALIANE

Për ata që marrin pjesë rregullisht në kontrollin për kancerin e zorrës së trashë, përqindja e vdekshmërisë dhe diagnozës ulet.

VDEKSHMËRIA

-65% tek burrat
-54% tek gratë

DIAGNOZË KANCERI

-33% tek burrat
-21% tek gratë



SI FUNKSIONON

Kontrolli përfshin testin për gjak të fshehur në feçe, duke përdorur një kampion që mund ta mbledhësh vetë në shtëpi.



- 1 MERR PAKETËN NGA VENDI I SPECIFIKUAR NË LETËR**
- 2 LEXO UDHËZIMET**
- 3 MBLIDH NJË KAMPION TË FEÇES ME NDIHMËN E SHKOPIT TË VËNË NË DISPOZICION**
- 4 DORËZO KAMPIONIN NË QENDRËN E SPECIFIKUAR NË LETËR**
- 5 REZULTATI DO TË DËRGOHET NË SHËTËPI OSE NË DOSJEN ELEKTRONIKE TË SHËNDETIT**

ÇDO DY VJET DO TË MARRËSH NJË FTESË

PËR TË PËRSËRITUR KONTROLLIN

Është e rëndësishme që ta përsëritësh testin, edhe nëse ndihesh mirë, sepse polipet dhe tumoret shpesh nuk shkaktojnë simptoma për vite.



ÇFARË NDODH KUR TESTI DEL POZITIV?

Prania e gjakut të fshehur në feçe nuk do të thotë automatikisht se ka një polip apo tumor. Gjakterdhja mund të shkaktohet edhe nga faktorë të tjerë, si **çarje**, **hemorroide** ose **divertikuliti**. Për këtë arsye, nëse testi rezulton pozitiv, është e rëndësishme t'i nënshtroheni **kolonoskopisë** së rekomanduar.

